



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 3364/prot.

3

Tiranë, më 24.10 2019

VENDIM

Nr. 50, datë 24.10 2019

***Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në  
“Kriminologji, në Fakultetin e Drejtësisë, UT***

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 77, pika 2; Udhëzimin e MASR-së Nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë” dhe Statutin e Univesitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e Fakultetit të Drejtësisë me shkresën Nr. 845/1 Prot., datë 17.07.2019, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 24.10.2019;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në “Kriminologji” me 120 kredite, të Fakultetit të Drejtësisë, të UT-së sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Dokumentacioni i plotë të përcillet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për miratim.

KRYETARI  
PROF. DR. MYNYR KONI

